



KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. 011/01-1128/2020

Datë: 28.05.2020

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 18 pika C të Statutit të Komunës së Gjakovës 01nr.011-10 i miratuar 16.12.2008, dhe nenin 9 pika 9.1 të Rregullores për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 28.05.2020 pas diskutimit lidhur me pikën 9 të rendit të ditës: Propozim Vendimi për mbështetje financiare të Shoqatës "Hendikos" në Gjakovë, e miratoi këtë:

V E N D I M

Për mbështetje financiare të shoqatës "Hendikos"

1. Miratohet kërkesa e Shoqatës "Hendikos" në Gjakovë për mbështetje financiare në vlerë prej 15.000€ me qëllim të përmirësimit të gjendjes së personave me aftësi të kufizuara, integrimin dhe pjesëmarrjen e tyre në shoqëri.
2. Mjetet financiare në vlerë prej 15.000€ të ndahen nga Kategoria e Subvencioneve komunale me qëllim të mbështetjes së realizimit të Planit operativ të Shpenzimeve të Shoqatës "Hendikos".
3. Obligohen organet e Administratës Komunale për kryerjen e të gjitha procedurave në harmoni me të gjitha aktet ligjore në fuqi, për ekzekutimin e mjeteve financiare sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.
5. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
 - Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
 - Arkivit

